

PROTOKOLLI

NË GJYKATA PËR ZBATIMIN E MASAVE PËR MBROJTJE NGA KOVID -19

1. HYRJA NË NDËRTESËN E GJYKATËS

- mbajtja e detyrueshme e distancës që duhet të jetë së paku 2 metra midis dy personave;
- dezinfektimin e detyrueshëm të duarve nga pajisja e vendosur në hyrje të godinës;
- mbajtja e detyrueshme e maskës mbrojtëse higjenike, e vënë në mënyrë të rregullt në fytyrë;
- matja e detyrueshme e temperaturës së trupit me termometër pa kontakt;
- kalimi i detyrueshëm i inspektimit të sigurisë përmes detektorit të metalit;
- paraqitura e detyrueshme në policinë gjyqësore me dokument personal të identifikimit;

2. HAPËSIRAT E PRITJES, KORRIDORET, SHKALLËT DHE ASHENSORËT

- mbajtja e detyrueshme e distancës duhet të jetë së paku 2 metra midis dy personave;
- mbajtja e detyrueshme e maskës mbrojtëse higjenike, e vënë në mënyrë të rregullt në fytyrë;
- përdorimi i detyrueshëm i ashensorëve me kapacitet të reduktuar (deri në dy persona);
- ajrosja e detyrueshme e hapësirave në mënyrë të natyrshme dhe dezinfektimi i sipërfaqeve të punës;

3. DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT DHE PRANIMIT

- mbajtja e detyrueshme e maskës mbrojtëse higjenike, e vënë në mënyrë të rregullt në fytyrë;
- numri i palëve duhet të jetë në përputhje me madhësinë dhe kapacitetin e hapësirave, gjë që mundëson mbajtjen e distancës, e cila duhet të jetë së paku 2 metra midis dy personave;
- Ndalohet hyrja dhe kohëzgjatja e panevojshme në sportelet e regjistrimit dhe hapësirat e pritjes;
- ajrosja e detyrueshme e lokaleve në mënyrë të natyrshme dhe dezinfektimi i sipërfaqeve të punës;

4. SALLAT E GJYKIMIT

- dezinfektimi i detyrueshëm i duarve nga pajisja e vendosur në hyrje të sallës së gjykimit;
- vënia e detyrueshme e maskës mbrojtëse higjenike, e vënë në mënyrë të rregullt në fytyrë;
- ajrosja e detyrueshme e sallave të gjykimit gjatë ose pas çdo gjykimi, në mënyrë të natyrshme dhe dezinfektimi i sipërfaqeve të punës;

- numri i palëve duhet të jetë në përputhje me madhësinë dhe kapacitetin e sallës së gjykimit, që mundëson mbajtjen e distancës, e cila duhet të jetë së paku 2 metra midis dy personave;
- ndalohet që palët të hyjnë dhe të qëndrojnë në sallën e gjykimit, nëse ato paraprakisht nuk janë të ftuar dhe nëse nuk është e nevojshme;
- hyrja e palëve në seancat e planifikuara dhe seancat kryesore do të kryhet sipas përparrësisë dhe domosdoshmërisë për të marrë pjesë në gjykim, përparrësi do të kenë palët në procedurë, përfaqësuesit e tyre, si dhe personat e tjerë të ftuar me ftesë gjyqësore;
- për praninë e personave të tjerë në sallat e gjykimit dhe në lidhje me zbatimin e masave të mbrojtjes vendos gjykatësi individual përkatësisht këshilli i ngarkuar me cështjen;
- pas përfundimit të seancës, palët janë të detyruara menjëherë të largohen nga salla e gjykimit dhe godina e gjykatës, përkatësisht të kufizojnë në minimumin qëndrimin e tyre;

5. ZYRAT DHE KABINETET

- Vënia e detyrueshme e maskës higjenike mbrojtëse, e vënë në mënyrë të rregullt në fytyrë nëse në hapësirë ka më shumë se dy persona;
- mbajtja e detyrueshme e distancës, e cila duhet të jetë së paku 2 metra midis dy personave;
- ajrosja e detyrueshme e hapësirave në mënyrë të natyrshme dhe dezinfektimi i sipërfaqeve të punës;
- ndalohet që palët të hyjnë dhe të qëndrojnë në këto hapësira nëse nuk janë ftuar më parë dhe nëse kjo nuk është e nevojshme;

6. MIJETET SANITARE

- kur përdoren tualetet për palët që vijnë në godinën e gjykatës, caktohet një tualet, i cili duhet të jetë i vendosur në katin përdhes ose në afersi të tij;
- ajrosja e hapësirave në mënyrë të natyrshme dhe dezinfektimi i sipërfaqeve sanitare;

